
MATERIALE SHKENCORE E KUMTESA

HALIT SHABANI

ZENEbishËT DHE DELVINA, ALEATË TË SKËNDERBEUT NGA “ARBËRIA E POSHTME”*

Në pragun e pushtimit osman të territoreve shqiptare, zotërimet e të ashtuquajturës “Shqipëria e Poshtme”, e cila konsistonte në vijën Delvinë – Prevezë, njihej me emrin “Vageneti“. Aty nga shek. XIV, familja feudale e Zenebishëve, e cila kishte si qendër të saj Gjirokastrën, do të shndërrohej në fuqinë më të madhe sunduese të atyre territoreve. Sundimtarët Zenebishi patën sukses jo vetëm në sektorin politik e ekonomik, por edhe në atë ushtarak duke arritur t’i zgjeronin territoret nën zotërimet e tyre. Për rrjedhojë, kjo familje e madhe zotëronte dalje në detin Jon duke patur nën kontrollin e vet disa porte të rëndësishme, përmes së cilave zhvillohej tregti me vendet fqinje. Brenda një kohe të shpejtë, Zenebishët do të bëheshin edhe zotër të kripores së Sajadhës, duke konkuruar në këtë mënyrë, me monopolin e kripës që zotëronte Venediku. Madje, pas vdekjes së Gjon Zenebishit, fitimet e mëdha të kripores së Sajadhës, u shndërruan në një konflikt të hapur me venecianët. Gjithashtu, vlen të theksohet se një zotërim me potencial kaq të madh kishte nxitur xhelozinë e sundimtarit të ishujve të Jonit, Karl Tokos.

Nisur nga dokumentacioni i kohës rezulton se qendrat më të zhvilluara të trevës në fjalë ishin Delvina, Kamenica, Sajadha dhe Butrinti. Prej këtyre, në aspektin ekonomik zonat më fitimprurëse ishin Sajadha me kriporen e saj si dhe dajlanet e Butrintit nga ku sigurohej tregtia e peshkut dhe ngjalës.

Deri në kohën kur kjo hapësirë u pushtua prej osmanëve, Zenebishët e fuqishëm i mbrojtën territoret e tyre nga Gjirokastra në veri për të vijuar deri në Prevezë në jug. Nga djemtë e Gjon Zenebishit, Simoni, u shndërrua në një nga princat më të fuqishëm në betejat shqiptaro-turke.

* Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore “Ditët e Albanologjisë”, sesioni IX, Tiranë, 3-4 dhjetor 2018.

Midis të tjerash në vitin 1443, Simon Zenebishi do të ndërtonte fortesën e Strovilit, e cila gjendet në majën e një kodre buzë detit Jon dhe pozicionohej midis Konispolit e Sajadhës, përballë ishullit të Korfuzit. Ngritja e kësaj pike strategjike që bërë në “Kepin e Vagenetisë”. Disa autorë si J. Rodoniç¹ dhe N. Jorga² e vlerësojnë si kontrolluese e vëzhguese të kanalit të Korfuzit dhe mbrojtëse e kriepores së Sajadhës. Vagenetia mesjetare përfaqësonte bërthamën e vërtetë të shqiptarëve, në krahasim me viset e tjera periferike në jug e lindje.

Ajo përbënte një histori të lidhur ngushtë me atë të krahinave fqinje shqiptare të Delvinës, Himarës, Vlorës, Gjirokastrës e Kurveleshit. Pas shek. XIV, italianët do ta quanin këtë territor si “Arbëri”, ndërsa venecianët “Terra ferma“ e “Albania“. Aty nga fillimi i shek. XV zotërimet osmane do të shtriheshin në thellësi të tokës. Kështu, aty rreth viteve 1430-37 do të kalonin nën sundimin osman jo vetëm një pjesë e Shqipërisë, apo Arbërisë por, edhe hapësira të mëdha të Ballkanit. Me gjithë përpjekjet për t’i ruajtur zotërimet, sundimtarët vendas e patën të pamundur t’i mbronin këto vise. Një përshkrim të ngjashëm e hasim tek Marin Barleti, i cili për të treguar përpjekjet për t’i ruajtur këto hapësira do të shkruante se:

“Më 1444 (Skënderbeu) ...ai si ndonjë profet i pagabuar paralajmëronte se kishte për t’i parë së shpejti mu në zemër të Epirit, vendosi të kërkonte ndihma të jashtme me qëllim që të kujdesej për punët e veta më me siguri dhe t’ia priste hovin furtunës, që, po i kërcënohej me ndihmën e të shumtëve. Kështu pra, vendosi se, para së gjithash, duhej hyrë në një aleancë dhe në një fazë besëlidhjeje të përherëshme me princërit dhe sundimtarët fqinj, epiriotë e ilirikë shqiptarë dhe sllavë.”³

Me pushtimet dhe përparimin ushtarak të osmanëve, vija Vlorë – Berat përbënte tanimë edhe kufirin jugor të shtrirjes së zotërimeve të Skënderbeut. Territoret e Tepelenës, Gjirokastrës e Delvinës mbeteshin nën sundimin osman. Por kjo nuk përbënte pengesë që paraardhësit e principatës së Zenebishëve të mos përkrahnin e të mos mbështesnin Lidhjen e Lezhës apo luftën e Skënderbeut kundër ushtrisë turke. Në këto vite vijnë sinjale nga kështjella e Strovilit apo Delvina, të cilat i

¹ Jovan Radonić, *Durađ Kastriot Skenderbeg i Arbanija u XV veku*, Beograd: Srpska Kraljevska Akademija, 1942, nr 98, f. 55.

² Nicolae Jorga, *Notes et extraits pour servir à l’histoire des Croisades au Moyen âge*, vëll.III. Paris: 1899, f. 145.

³ Marin M. Barleti, *Historia e Skënderbeut*, Tiranë: 1967, f. 116.

bashkoheshin edhe lëvizjes së arvanitasve, për të mbështetur qëndresën antiosmane të Skënderbeut. Ato lëvizje interesante flasin për bashkimin e tërë trojeve të Arbërisë, për të formuar një shtet të fortë të drejtuar nga Skënderbeu.

Në lidhje me kontributin e hapësirës së Vagenetisë dhe ish zotërimeve të Zenebishëve në përpjekjet e Skënderbeut, vlen të theksohet edhe një aspekt tek vepra e Marin Barletit, kur ai flet për shpata të shkurtëra, duke thënë se: *“Të patrembur rrëmbyen shpatat e shkurtra, sepse ngushtia e vendit, nuk lejonte të gjatat”*⁴. Pikërisht këtu duhet të theksojmë se ekzistojnë informacione nga autorë të ndryshëm se shpatat e shkurtëra farkëtoheshin në Delvinë.

Njëkohësisht kjo lidhje e trevës jugore të Arbërisë me Skënderbeun na del edhe më vonë, në vitin 1466, kur Skënderbeu u kthye nga Roma:

*“Ky Skënderbe, pasi u kthye nga Roma mblodhi nga çdo anë dhe bashkoi në një vend, një ushtri shumë të madhe dhe forca të papara të fuqishme dhe më të vërtetë tek erdhën gjithë sundimtarët aleat dhe fqinjë rreth e rrotull, u grumbulluan çdo ditë, gjithë popullsitë, si prej Epiri, Maqedonia, si prej Ilirie e Dalmacie ...”*⁵

Sigurisht që brenda ushtrisë së ardhur bënin pjesë edhe luftëtarët nga Delvina. Në një dokument të vitit 1454 paraqitur nga historiani Guzepe Valentini për kështjellën e Strovilit, nga ish pronari i saj Simon Zenebishi, thuhej se:

*“Zot i Strovilit në Arbëri. Ç’është gjithashtu një tjetër vend, qyteti i Gjirokastrës me Vagenetinë e Parakalamanë, ku gjendet një kështjellë me emrin Strovil, aktualisht e rrënuar, ky vend i përkiste zotit Simon Zenebishi.”*⁶

Më 20 gusht 1455 vetë Mbreti Alfonsi i V i Napolit i shkruante vasalit të tij Simon Zenebishit, zot i kështjellës së Strovilit në Shqipëri. Ndërkohë kishte ndodhur një ngjarje interesante ku një djalë i Simonit, i cili ishte arratisur nga oborri i sulltanit, kishte arritur të gjente strehë tek Mbreti i Napolit, prej të cilit do të pagëzohej me emrin Alfons. Vetë

⁴ *Po aty*, f. 71.

⁵ *Po aty*, f. 638.

⁶ *Dispacci sforzeschi da Napoli*, a cura di Francesco Senatore, Istituto Italiano per gli studi Filozofici, Napoli: Carlone Editore, 1997, f. 230.

monarku do të angazhohej në përpjekjet çlirimtare të shqiptarëve duke ndërmarrë disa hapa konkrete për t'iu ardhur në ndihmë atyre.

Parë në këtë këndvështrim, të parët mes fisnikëve shqiptarë në emigracion, të cilët tentuan të rikuperonin zotërimet e tyre në Shqipëri, duke dëbuar prej andej osmanët, ishin Zenebishët e Gjirokastrës e të Vagenetisë (Çamërisë). Përpjekjet e tyre disavjeçare patën për epiqendër fortesën e vogël të Strovilit, afër Sajadhës. Kjo duhet të ishte baza nga ku Zenebishët e Napolitanët, që ishin në krah të tyre, shpresonin të shtriheshin më në thellësi të territorit shqiptar, duke dëbuar prej aty pushtuesit turq.⁷

Në një letër për Dukën e Milanos, Francesco Forca i dërguari i tij në Napoli, A. Malleta e ilustron më së miri këtë politikë të Alfonsit të Napolit, tek sa evidenton tre aksione të ndërmarra prej tij në Shqipëri në vitin 1455. Tentativa për çlirimin e Beratit, bashkë me trupat e Skënderbeut, vazhdimin e ofensivës antiosmane, duke çliruar prej turqve edhe qytetin e Vlorës, si dhe zbarkimin në Strovil të Sajadhës i Zenebishëve. Por këto aksione do të zhvilloheshin në kushte e rrethana të vështira ku, përveç përpjekjeve antiosmane pati edhe një përplasje shumë të fortë të interesave të Venedikut e Napolit në Shqipëri.

Sipas A. Malletës (i dërguari i venecianëve në Napoli) “*Sundimtari shqiptar Simon Zenebishi, i cili deri atëherë kishte qënë vasal i turqëve, kishte çuar fjalë tek mbreti i Napolit se dëshironte të lidhej me të dhe t'i vinte zotërimet e tij që ndodheshin në bregdet 12 milje larg Korfuzit venecian nën mbikqyrjen e sovranit napolitan.*”⁸ Në letërkëmbimet e mëvonshme Alfonsi i Napolit kërkonte: “*Venediku ta trajtonte Zenebishin, vasalët dhe zotërimet e tij si të ishin Mbretëria e Napolit. Zenebishët ishin rreshtuar tanimë, me frontin antiosman, ndërsa Venedikun e trajtonin si armik të tyre.*”⁹ Shumë nga këto evidencime të historianëve venecianë e sidomos të Guzepe Valentinit në adresë të Zenebishëve dhe fortesës së Strovilit i ka analizuar e thelluar më tej P. Xhufi tek libri voluminoz “*Arbërit e Jonit*”.¹⁰ Gjithsesi, vitet 1455 -1456 përbëjnë edhe periudhën ku me shumë intensitet flitet për lidhjet midis

⁷ Pëllumb Xhufi, *Arbërit e Jonit*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Onufri, 2016, f. 34.

⁸ *Po aty*, f. 172-173.

⁹ *Po aty*, f. 361.

¹⁰ *Po aty*, f. 366-376.

Skënderbeut, Alfonsit të V të Napolit dhe Simon Zenebishit e djalit të tij të pagëzuar, Alfonsit.

Rekomandimet e mikut të Skënderbeut, Mbretit të Napolit për siguri tek aleancat me Zenebishët dhe “Vasalët e tyre” përbëjnë një garanci të frontit antiosman edhe në “Arbërinë e Poshtme”, megjithëse kjo hapësirë gjendej nën sundimin osman. Kjo gjë evidentohet edhe nga K. Biçoku, i cili shprehet se:

“Në tërësi të dokumentacioneve veneciane, turke e napoletane të këtij fronti antiosman, gjithçka flet në të mirë të mendimit se Zenebishët i ishin bashkuar kryengritjes së madhe të Gjergj Kastriot Skënderbeut.”¹¹

Në përfundim, mund të theksojmë se e gjithë bota e krishterë, duke filluar me Mbretërinë e Spanjës, Napolit, Hungarisë e me në krye Papatin ishte mobilizuar për të ndaluar invazionin osman. Por, Skënderbeu ishte ai që realizoi ndalimin e atij invazioni për 25 vjet edhe pse nuk u ndihmua aq sa meritonte nga ajo botë e pasur dhe e fuqishme evropiane për kohën.

¹¹ Kasem Biçoku, *Për Skënderbeun*, Tiranë: Botimpex, 2005, f. 307-311.

